



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 16, Datë 06.02.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SH.P.K.  
PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË  
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 127/4prot., datë 31.01.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021, për një afat 5-vjeçar, si dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, për një afat 5-vjeçar.
- Shoqëria ka njoftuar ERE-n se ka realizuar shitjen e 100% të kuotave nga pala shitëse (BALFIN - Balkan Finance Investment Group sh.p.k.) në favor të palës blerëse (Yildirim Albania Mining Investments sh.p.k.). Duke qenë se akti i kalimit të kuotave është nënshkruar përpara se të merrej autorizimi përkatës i ERE-s për këtë transferim, në ERE është depozituar dhe Shtojca 1 e këtij akti, nëpërmjet së cilës shitësi dhe blerësi kanë rënë dakord se transferimi i kuotës do të hyjë në fuqi me kusht marrjen e autorizimit për transferim nga ERE. Në rast se miratimi nuk jepet, palët garantojnë dhe deklarojnë se kuota do t'i kthehet shitësit sikur transaksioni të mos kishte përfunduar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në

nenin 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k.
2. Ortak i vetëm i shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. bëhet shoqëria “Yildirim Albania Mining Investments” sh.p.k.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**